VENDIM
Nr. 23, datë 18.4.2016

PËR SHPËRNDARJEN E FINANCIMIT PËR PROJEKTE TË GRANTIT "SHËNDETËSIA", THIRRJA E PARË, PROGRAMI I ZHVILLIMIT TË INFRASTRUKTURËS VENDORE DHE RAJONALE, SHTYLLA I, PËR VITIN 2016

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 15 e të aneksit 3, të ligjit nr.147/2015, "Për buxhetin e vitit 2016", Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve

VENDOSI:

1. Shpërndarjen e fondeve për projekte të reja, thirrja e parë, për vitin 2016, për grantin e shëndetësisë (shërbimet e kujdesit shëndetësor parësor), programi i zhvillimit të infrastrukturës vendore dhe rajonale, shtylla I, sipas tabelës 1 bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Autoriteti kontraktues, projekti i të cilit miratohet për t'u financuar, sipas pikës 1, të këtij vendimi, brenda një jave nga data e publikimit të tij në Fletoren Zyrtare, duhet të paraqesë në sekretariatin teknik, pranë Ministrisë së Shëndetësisë, kalendarin me të gjitha afatet e parashikuara për fazat e prokurimit publik dhe të zbatimit të punimeve të ndërtimit e përdorimit të fondeve, si dhe emrin e personit përgjegjës për informim.

3. Autoriteti kontraktues, për projektin sipas pikës 1, të këtij vendimi, duhet të kryejë procedurat e prokurimit publik dhe të lidhjes së kontratës përkatëse për zbatimin e punimeve të ndërtimit deri në fillim të tremujorit të tretë të vitit 2016. Për fondin e projektit të paprokuruar sipas këtij afati, Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve ka të drejtën të rishqyrtojë financimin dhe ta rishpërndajë atë për një projekt tjetër.

4. Ngarkohet sekretariati teknik në Ministrinë e Shëndetësisë, të kryejë monitorimin e ecurisë së përdorimit të fondeve, sipas kalendarit të paraqitur nga autoritetet kontraktuese, në përputhje me pikën 2 të këtij vendimi, dhe të informojë Ministrinë e Financave, dhe periodikisht Komitetin për Zhvillimin e Rajoneve, përmes Sekretariatit të Përgjithshëm të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve.

5. Ngarkohen ministri i Shëndetësisë dhe ministri i Financave, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYETARI
Niko Peleshi

Zëvendëskryeministri	Zëvendëskryetar;
Ministri i Financave	anëtar;
Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes	anëtar
Ministri i Zhvillimit Urban	anëtar;
Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës	anëtar;
Ministri i Arsimit dhe Sportit	anëtar;
Ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave	anëtar;
Ministri i Shëndetësisë	anëtar;
Ministri i Kulturës	anëtar;
Ministri i Mjedisit	anëtar;
Ministri i Punëve të Brendshme	anëtar;
Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike	anëtar;
Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore	anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Qarqeve të Shqipërisë	anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë / Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.1	anëtar;
Kryetari i Shoqatës për Autonomi Vendore / Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.2	anëtar;
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.3	anëtar;
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.4	anëtar.

Tabela 1. Lista e projekte të reja për financim, thirrja e parë, përmes grantit të shëndetësisë (shërbimet e kujdesit shëndetësor parësor), Programi i Zhvillimit të Infrastrukturës Vendore dhe Rajonale, shtylla I, për vitin 2016.

Nr.	**Autoriteti Kontraktues**	**Emërtimi i Projektit**	**Vlera e plotë e projektit (në lekë)**	**Vlera e financimit për vitin 2016 (në lekë)**	**Vlera e financimit për vitin 2017 (në lekë)**
1	Bashkia Kamzë	Rikonstruksioni i Qendrës Shëndetësore, në Bashkinë Kamzë	83,873,529	13.185.209	70.688.320
	TOTALI		**83,873,529**	**13.185.209**	**70.688.320**

Shënim.

1. "Vlera e plotë e projektit" përfaqëson vlerën brenda së cilës caktohet fondi limit për prokurimin e zbatimit të punimeve (kur nuk ka financim tjetër nga autoritetet kontraktuese). Kjo vlerë shërben si referencë për përllogaritjen e vlerës së financimit për vitin 2016 dhe korrektohet nga vlera e kontratës, pas nënshkrimit të saj. Fondi i përftuar nga diferenca midis vlerës së projektit dhe vlerës së kontratës, pas nënshkrimit të kontratës, i shtohet portofolit të grantit të "Shëndetësisë (shërbimet e kujdesit shëndetësor parësor)", Programi i Zhvillimit të Infrastrukturës Vendore dhe Rajonale, shtylla I, dhe shpërndahet për financimin e projekteve të reja. Vlera e plotë e projektit përcillet nga sekretariati teknik (Ministria e Shëndetësisë).
2. "Vlera e financimit për vitin 2016" tregon vlerën e financimit që vihet në dispozicion nga buxheti i Fondit për Zhvillimin e Rajoneve për vitin 2016.
3. "Vlera e financimit", për vitin 2017, tregon vlerën e mbetur të financimit, pas diferencës midis vlerës së kontratës dhe vlerës së financimit për vitin 2016.